



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.63, datë 31.07.2024

**PËR**  
**SHFUQIZIMIN E LEJEVE PËR STRUKTURA SHËRBIMI NË STACIONET E PLAZHIT**  
**PËR PARCELAT NR. VL-152 DHE NR. VL-156 ME VENDNDODHJE NË BASHKINË**  
**VLORË DHE ZHVILLUES ZNJ. SILVIRA LALIKE**

Në mbështetje të neneve 113, 116 të Kodit të Procedurave Administrative, Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar, VKM-së Nr.171, datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar, VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Shfuqizimin e Lejeve për struktura shërbimi në stacionet e plazhit për parcelat Nr. VL-152 dhe Nr. VL-156, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë dhe zhvillues Znj. Silvira Lalike, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.22, datë 05.04.2024 “Për miratimin e lejeve të ndërtimit për objektet: “Struktura shërbimi në stacionet e plazhit”, me vendndodhje në bashkitë: Pogradec, Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë”.
2. Në tabelën e Hartës së Planvendosjes së Strukturave, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.22, datë 05.04.2024, shfuqizohen stacionet e plazhit për numrat rendore 9 dhe 13.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.


KRYETARI  
EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 31/12/ 2024